



ANEKS KONTRATA

Në mes të

Date:09.10.2020

Komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejme Autoriteti Kontraktues)

Dhe

“Multi Business Group” adresa Prizren përfaqësuar nga Jeton Bytyqi, me numër të regjistrimit të biznesit 811033258 në tekstin e mëtejme (“Kontraktuesi”), janë pajtuar të lidhin këtë Aneks kontrate

Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të përmendura më lartë kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e punëve për: **Ndërtimi i ndriçimit publik nër rugët e qytetit dhe në fshatrat Peran, Bajçinë, Letanc, Obrançë dhe Surkish (Ilot III) me nr. të prokurimit 615-20-520-5-2-1, nr i brendshëm 61520011521 të datës: 20.08.2020**, e cila kontratë është në realizim e sipër

- i. Duke u bazuar në kërkesën për punë shtesë nga menaxheri i projektit dhe arsyetimet për mospërfshirjen e punëve shtesë në kontratën bazë, në njoftimin për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, në vendimin mbi aprovimin e punëve shtesë të kontratës dhe kryerjen e suksesshme të punëve për **Ndërtimi i ndriçimit publik nër rugët e qytetit dhe në fshatrat Peran, Bajçinë, Letanc, Obrançë dhe Surkish (Ilot III) - punë shtesë**, Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi pajtohen që të lidhin aneks kontratë për kryerjen e punëve shtesë sipas ofertës së datës **06.10.2020** me kushte të njëjta si në kontratën bazë.

ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:

1. Kontrata bazë që është duke u përmbushur, është vazhduar edhe për kryerjen e punëve shtesë të pa parashikuara si marrëveshje reciproke në mes palëve.
2. Çmimi i punëve shtesë është gjithsej: **2,727.31 €** (dymijëeshtatëqindnjëzetëeshtatëeurotridhjetëenjëcent sipas përshkrimeve të punëve dhe sasive të dhëna në Dosjen e tenderit nr. [61520011521/5] .
3. Punët shtesë kontraktohen bazuar në përshkrimin e punëve shtesë të Menaxherëve të Projektit, Njoftimit në KRPP dhe kushteve të negociuara në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit që janë pjesë e këtij Aneksi të Kontratës.
4. Pagesa e punëve shtesë do të bëhet në bazë të konstatimit të Personave të Autorizuar të Autoritetit Kontraktues pas perfundimit të punëve.
5. Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
 - a. Marrëveshja e kontratës;
 - b. Përshkrimi i punëve shtesë nga Menaxherët e projektit që duhet të realizohen;
 - c. Njoftimi në KRPP për punët shtesë.
6. Të gjitha kushtet tjera të kontratës bazë mbesin të njëjta.

7. Kontrata hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të sa dhe përfundon sipas planit dinamik e që është 10 ditë

Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin

Për Autoritetin Kontraktuesin		Për Kontraktuesin	
Emri:	Rasim Fejza	Emri:	Jeton Bytyqi
Pozita:	menaxher i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	09.10.2020	Data:	09.10.2020
Vula:		Vula:	